



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 496 S/3 Prot

Rrëshen më, 30 . 12 . 2024

V E N D I M

Nr. 111 datë 27.12.2024

PËR

RISHQYRTIMIN E VKB-SË NR. 99, DATË 04.12.2024 TË KËSHILLIT TË BASHKISË MIRDITË “PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE DHE SHITESAVE TË PAKETËS FISKALE NR. 100 DATË 30.11.2022” DHE VENDIMIT NR. 45 DATË 15.12.2023, “PËR DISA NDRYSHIME TË VITIT 2024”, PËR VITIN 2025, BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të nenit nr. 8 pika 2, nenet 34 dhe 54 shkronja f të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” (i ndryshuar), ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar), ligji nr. 8378 datë 22.07.1998 “Kodi rrugor në RSH” (i ndryshuar), VKM nr. 132 datë 07.02.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa” e bazës së taksës për kategori specifike, nenit 128 të ligjit 8485, ligjit 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 32 datë 31.12.2013 të Ministrit të Financave “Për miratimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, udhëzimit nr. 15 datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor”, udhëzimin nr. 5627 datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionin për lëshimin e certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” (i ndryshuar), ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”, ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar), VKM nr. 607 datë 29.07.2020 “Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, legjislacionit të aplikueshëm në fuqi, akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara, pas *Dëgjësës Publike e zhvilluar me datë 24.12.2024 me kompanitë që ushtrojnë aktivitetet hec-e, kërkim, nxjerrje dhe përpunim mineralesh*, Relacionit nr. 4965/1 prot, datë 26.12.2024, të përgatitur së bashku me projekt vendimin e Kryetarit të Bashkisë, shqyrtimin/miratimin në mbledhjen e datës 24.12.2024 të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit, për ta kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve:

V E N D O S I:

1. Rishqyrtimin e VKB-së, nr. 99, datë 04.12.2024, “Për miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave në VKB 100, datë 30.11.2022 “Për miratimin e Paketës Fiskale Vendore 2023”, të ndryshuar me VKB nr. 45 datë 15.12.2023 si mëposhtë vijon:

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

ëëë.bashkiamirdite.gov.al

2. Në seksionin III “Tarifa Vendore”, pika 1 “Tarifa e shërbimeve publike për komunitetin”, tabela 1.2 e tarifës së pastrimit, mbledhjes, largimit të mbetjeve urbane dhe inerteve etj. të ngjashme për biznesin e vogël shtohet pika:

- Tregu i qytetit dhe biznese që ushtrojnë aktivitetin në objekte materiali tip llamarine ose të ngjashme me to 10 000 lekë/vit

3. Në seksionin III “Tarifa Vendore”, paragrafi 5 “Tarifa e parkimit” ndryshohet pika 3 si mëposhtë:

Ishte

“Parkimi i automjeteve në parkingje të vijëzuara nga bashkia sipas biletave të tregut deri në një orë falas. Mbi një orë 100 lekë/orë

Për çdo vend parkimi autoveturë 4+1 20,000 lekë bashki

Për çdo vend parkimi autoveturë 4+1 5,000 lekë njësitë administrative

Për çdo vendparkimi autobus apo kamion 30,000 lekë bashki

Për çdo vendparkimi autobus apo kamion 10,000 lekë/njësitë administrative

Bëhet

Parkingu autoveturave taksi 4+1 20,000 lekë/vit

Parking për autobusa/kamiona (jo shoqëri) 30,000 lekë/vit

Parking për bizneset (veturë) 25,000 lekë/vit

Parking për bizneset (furgon) 30,000 lekë/vit

Tarifë parking publik 50 lekë/ora

4. Në seksionin III “Tarifa Vendore”, pika 7 “Tarifa e zënies së hapësirës publike”, bazuar në vendimin 45 datë 15.12.2023:

Ishte

Tarifa e zënies së hapësirës publike (përdorim sipërfaqe për biznes) 100 lekë/m²/vit

Bëhet

“Tarifa e zënies së hapësirës publike (përdorim sipërfaqe për biznes) 200 lekë/m²/vit

5. Të rishqyrtojë pikën 4, të relacionit nr. 4466 prot., datë 27.11.2024 “Për Miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave të Paketës Fiskale nr. 100 Datë 30.11.2022 dhe Vendimit Nr. 45 datë 15.12.2023, “Për disa ndryshime të vitit 2024”, për Vitin 2025, Bashkia Mirditë”

Në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni nr. 35 pika 5, nënpika ç “*Bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për çdo tarifë tjetër të përkohshme, në përputhje me rrethana të përcaktuara me ligj*”, ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni nr. 17, “**Tarifa të tjera**”

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të vendosin tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Niveli i këtyre tarifave përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe vendoset për individët, personat fizikë ose juridikë që ushtrojnë aktivitete, efekti i të cilave në mjedis është i qartë, i matshëm dhe i atribueshëm për aktivitetin në fjalë.”:

Shtohet:

Tarifë përmbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit (për krijimin e një fondi publik në interes të komunitetit)

- Hec-e deri në 2 mega;..... 50 000 lekë/vit
- Hec-e 3-5 mega;.....150 000 lekë/vit
- Hec-e mbi 5 mega;.....500 000 lekë/vit
- Subjekte përpunim mineralesh;.....300 000 lekë/vit
- Subjekte nyje inerte;.....300 000 lekë/vit

Shtohet:

“Tarifë bilete hyrje në Pallatin e Kulturës për aktivitete të ndryshme kulturore artistike dhe Pallati i Sportit “Ariana Arapi” si mëposhtë:

- Biletë hyrje Pallati i Kulturës;.....200 lekë
- Biletë hyrje Pallati i Sportit “Ariana Arapi”100 lekë

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë

SEKRETAR
Gaspër TOPOLLAJ



KRYETAR
Aleksandër PICAË

